

RELACION

PËR

AKTIN NORMATIV “PËR MARRJEN E MASAVE URGJENTE PËR MBROJTJEN DHE PËRMIRËSIMIN E INFRASTRUKTURËS SË UJËRAVE TË NDOTURA QË DËRDHEN NË UJËRA LARËSE”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Akti normativ “Për marrjen e masave për monitorimin, mbrojtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës së ujërave të ndotura që derdhen në ujëra larëse”, iniciohet për shkak të situatës emergjente mjedisore, të krijuar nga subjektet fizike dhe juridike, që ushtrojnë aktivitet ekonomik në zonat bregdetare ose në bregun e liqeneve e të lumenjve dhe shkarkojnë ujërat e ndotura në ujëra larëse, pa i trajtuar sipas standardeve.

Aktualisht në Shqipëri mbulohet me rrjet kanalizimesh të ujërave të ndotura urbane rreth 55% e zonës së shërbimit, ku zonat e shërbimit urbane mbulohen me rreth 83% dhe zonat e shërbimit rurale mbulohen me rreth 14%. Në nivel kombëtar janë në operim 10 impiante të trajtimit të ujërave të ndotura urbane (në vijim ITUN) dhe janë në proces ndërtimi edhe 4 ITUN-e të tjera, që në total do të mbulojnë rreth 14.8% të territorit.

Zonat bregdetare ose në bregun e liqeneve e të lumenjve mbulohen pjesërisht me rrjet kanalizimesh të ujërave të ndotura urbane dhe ITUN-e. Shumica e këtyre zonave ka mungesë rrjeti kanalizimesh për të mbuluar të gjithë zonën e shërbimit, si dhe në ato zona ku rrjeti ekziston ka kapacitete të limituara grumbullimi dhe transportimi të ujërave të ndotura, duke shkaktuar në vazhdimësi shkarkime të pakontrolluara në mjediset pritëse. Në këto zona janë në operim 8 ITUN-e, me kapacitet të limituar trajtimi prej rreth 700,000 njëvlerës popullsie (PE) ose vetëm 24% të ngarkesës totale të ndotjes të gjeneruar nga ujërat e ndotura urbane, në shkallë kombëtare. Kapaciteti aktual gjithashtu nuk mund të përballojë prurjet dhe respektivisht ngarkesën e ndotjes së lartë që gjenerohet për më tepër edhe gjatë sezonit turistik veror. Gjithashtu, niveli i trajtimit i ITUN-eve ekzistuese pjesërisht plotëson kërkesat e direktivës evropiane për trajtimin e ujërave të ndotura urbane 91/271/EEC, ku nëpërmjet të cilës kërkohet mbulim me trajtim të nivelit të dytë, trajtim biologjik, të ujërave të ndotura urbane për të gjitha zonat e banuara me përqendrim të popullsisë më të madh se 2,000 njëvlerës popullsie (PE). Në kuadër të procesit të negociimeve me Bashkimin Evropian është përgatitur plani i investimeve për plotësimin e kërkesave të direktivës evropiane

për trajtimin e ujërave të ndotura urbane 91/271/EEC, ku në shkallë kombëtare janë planifikuar të ndërtohen të reja 114 ITUN, nga ku 12 ITUN-e duhet të ndërtohen vetëm në zonat bregdetare ose në bregun e liqeneve e të lumenjve.

Gjithashtu, në kuadër të këtij procesi në të njëjtat zona duhet të ndërtohet rrjet i ri kolektore kanalizimesh për transportin e ujërave të ndotura prej rreth 50 km.

Me qëllim përballimin e situatave të vështira të krijuara është domosdoshmëri trajtimi i ujërave të ndotura urbane nga vetë subjektet tregtare, në zbatim edhe të parashikimeve në legjislacionin ekzistues në fuqi.

Situata emergjente u konstatua nga institucionet përgjegjëse për kontrollin e mjedisit, kryesisht gjatë sezonit turistik veror 2023, ku ndotjet e dukshme mjedisore, shkarkimet e pakontrolluara në ujëra larëse dhe problemet me gropat septike, krijojnë një ambient të ndotur, me pasoja për shëndetin e njerëzve dhe me efekt negativ në klimën e turizmit.

Nëse krahasojmë parametrat e cilësisë së ujërave larëse në Shqipëri, vërehet se janë shumë të ulët në krahasim me shtetet e rajonit me turizëm të zhvilluar, si Greqia, Kroacia apo Italia. Në vijim, paraqitet një krahasim sipas raportit të Agjencisë Evropiane të Mjedisit.

<https://www.eea.europa.eu/themes/water/interactive/bathing/state-of-bathing-waters>

Cilësia e ujërave/ Shteti	Shqipëri	Bullgari	Greqi	Kroaci	Itali
Numri i pikave të monitorimit	123	96	1682	936	5529
Shkëlqyer	67%	93%	97%	96%	90%
Mirë	20%	7%	1%	3%	6%
Mjaftueshëm	4%	0%	0%	1%	2%
Keq	9%	0%	0%	0%	2%
Pa klasifikuar	0%	0%	2%	1%	0%

Me rritjen e shpejtë të strukturave akomoduese në zonat bregdetare dhe rritjen e numrit të turistëve rrezikojmë që këto tregues të përkeqësohen gjatë vitit 2024, nëse subjektet tregtare dhe strukturat akomoduese nuk zbatojnë kërkesat e ligjit për trajtimin e ujërave të ndotura, pasi zgjerimi i ITUN-eve ekzistuese në zonat bregdetare dhe ndërtimi i ITUN-eve të reja kërkon kohë që të adaptohet me rritjen e shpejtë të numrit të turistëve.

Me qëllim, që në vitin 2024 dhe sezonin turistik që do të vijë, të kemi një pamje të tjetërsuar, të të gjithë panoramës së mësipërme është e nevojshme ndërhyrja e menjëhershme nëpërmjet këtij akti normativ, për të bërë të mundur që ujërat e ndotura trajtohen sipas standardeve dhe rregullave në fuqi, trajtimi i tyre të kontrollohet nga strukturat përgjegjëse dhe subjektet që ushtrojnë aktivitetin e

tyre në këto zona të nxiten për të marrë masat për rregullimin e trajtimit të ujërave në mënyrën e duhur.

Ndër rregullat që parashikon ky akt normativ është vlerësuar e nevojshme edhe ngritja e një Task-Force të dedikuar, nën varësinë e Agjencisë Kombëtare të Ujësjiellës-Kanalizimeve, me qëllim monitorimin, inspektimin dhe marrjen e masave administrative të nevojshme për disiplinimin e shkarkimit të ujërave të ndotura, të pakontrolluara dhe të patrajuara që derdhen në ujërat larëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Miratimi i këtij projektakti normativ nuk është i planifikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë apo të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, që do të paraqite për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, për vitin 2023

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Gjatë monitorimeve në terren nga ana e institucioneve inspektuese, në bashkëpunim me Agjencinë e Ujësjiellës-Kanalizimeve është vënë re gjithashtu se pjesa me e madhe e subjekteve tregtare që operojnë strukturat akomoduese gjatë vijës bregdetare nuk zbatojnë kërkesat e legjislacionit për trajtimin e ujërave të ndotura dhe shkarkimin e tyre, të cilat paraqesin problematika të ndryshme sa i përket kushteve zgjidhjeve individuale të trajtimit të ujërave të ndotura, siç janë gropat septike. Gjithashtu, është konstatuar që edhe ato subjekte që janë në proces ndërtimi nuk janë duke zbatuar kërkesat e legjislacionit në fuqi për largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura.

Si rezultat i inspektimeve të kryera vetëm gjatë vitit 2023, në subjekte fizike dhe juridike, që ushtrojnë aktivitetin ekonomik dhe shkarkojnë ujëra të ndotura, të patrajuara pranë ujërave larëse, janë konstatuar mungesa në ndërtimin dhe funksionimin e sistemit të kanalizimeve të brendshëm për largimin e ujërave të ndotura të patrajuara deri në kolektor, mungesa në ndërtimin dhe funksionimin e ITUN-eve të nevojshme, në përputhje me kapacitetet përkatëse të trajtimit të ujërave të ndotura të patrajuara, mungesës së trajtimit të llumrave dhe të lëndëve të ngurta, që dalin nga impiantet e trajtimit, shkarkime të pakontrolluara në mjedisin pritës, probleme strukturore të gropave septike, që rezultojnë në rrjedhje të pakontrolluar të ujërave të ndotura në mjedis të hapur.

Sidomos në sezonin e pikut turistik veror, vërehet ndotje e dukshme mjedisore aty ku zgjidhja teknologjike e largimit të ujërave të ndotura bëhet me anë të gropave septike, për arsye se nuk arrijnë të pastrohen në kohë nga ana e subjekteve të licencuara për evadimin e ujërave të ndotura nëpërmjet mjeteve teknologjike.

Në shumë raste mungon kontrata me këto subjekte që bëjnë evadimin e ujërave të ndotura, dhe në raste të tjera, gropat septike nuk janë në standardet e duhura për ruajtjen e pastër të mjedisit rrethues.

Nisur nga situata e emergjencës mjedisore e krijuar drejtpërsëdrejt nga subjektet fizike dhe juridike që ushtrojnë aktivitetin ekonomik, duke shkarkuar ujëra të ndotura të patrajtuara në ujëra larëse, del i nevojshëm sensibilizimi dhe marrja e masave konkrete nga këto subjekte që të kontribuojnë drejtpërsëdrejt në përmirësimin e situatës mjedisore, parandalimin e ndotjes në ujërat larëse dhe mjedisit prej ujërave të ndotura dhe kufizimin e ndikimit kur ajo ndodh nëpërmjet ndërtimit të sistemeve individuale të trajtimit të ujërave të ndotura të patrajtuara, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Duke qenë se situata e emergjencës mjedisore së krijuar është mbartur ndër vite dhe nuk ka rezultuar në zgjidhje të qëndrueshme nga institucionet inspektuese në vend, është vlerësuar marrja e masave nëpërmjet këtij akti normativ, i cili ndër të tjera ngarkon Këshillin e Ministrave për miratimin e një rregullore reknike të detajuar me qëllim disiplinimin e trajtimit të ujërave të ndotura që duhet të zbatohen nga subjektet që zhvillojnë aktivitetet në zonat bregdetare ose në bregun e liqeneve e të lumenjve, në përputhje me rregullat dhe kërkesat e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për administrimin, trajtimin apo shkarkimin e ujërave të ndotura. Gjithashtu, parashikohet dhe ngritja e një Task-Force të dedikuar, me qëllim monitorimin, inspektimin dhe marrjen e masave administrative të nevojshme për disiplinimin e shkarkimit të ujërave të ndotura, të pakontrolluara dhe të patrajtuara që derdhen në ujërat larëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Task-Forca duhet të drejtojë procesin e monitorimit dhe inspektimit, bazuar në legjislacionin në fuqi për trajtimin e ujërave të ndotura, si dhe bazuar në rregulloren teknike, e cila do të shërbejë si një udhëzues praktik për standardet teknike që duhet të plotësojnë instalimet individuale për trajtimet e ujërave të ndotura të patrajtuara, në operim nga subjektet fizike dhe juridike që shkarkojnë ujëra të ndotura në ujërat larëse.

Nëpërmjet kësaj rregulloreje synohet të vendosen një sërë rregullash, me qëllim disiplinimin dhe eliminimin e shkarkimeve të ujërave të ndotura të patrajtuara në ujërat larëse.

Në kuadër të përcaktimeve ligjore, del e nevojshme lidhja e çdo objekti me rrjetin publik të kanalizimeve dhe, në kushtet kur rrjeti publik mungon, del i nevojshëm trajtimi i ujërave të ndotura nga çdo subjekt fizik apo juridik që ushtron veprimtari ekonomike pranë ujërave larëse.

Duke marrë në konsideratë se në rang vendi përllogariten rreth 9 000 persona fizikë dhe juridikë, që ushtrojnë aktivitet ekonomik dhe shkarkojnë ujërat e ndotura të patrajuara pranë ujërave larëse, përbërja e Task-Forcës duhet të jetë e tillë që të ketë efikasitet në përmbushjen me sukses të objektivave, për të cilat do të ngrihet.

Nëpërmjet këtij akti normativ, në përfundim pritet që subjektet që ushtrojnë aktivitet ekonomik në zonat bregdetare ose në bregun e liqeneve e të lumenjve të standardizojnë sipas rregullave në fuqi, trajtimin e ujërave të ndotura.

Objektet që janë në proces ndërtimi do të marrin masat paraprake që në fillim për pasjen e sistemit të trajtimit të ujërave të ndotura.

Nëpërmjet Task-Forcës do të bëhet në mënyrë më të imtësishme dhe të rreptë, kontrolli i territorit për zbatimin e legjislacionit në fuqi për trajtimin e ujërave të ndotura.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Akti normativ është në përputhje me nenin 101 të Kushtetutës. Përveç situatës emergjente të konstatuar në terren dhe mjedis nga strukturat përgjegjëse, në lidhje me trajtimin e ujërave të ndotura, gropat septike, nevoja për të ndërhyrë me akt normativ në mënyrë emergjente është me qëllim që subjektet të plotësojnë standardet e nevojshme për trajtimin e ujërave të ndotura, përpara fillimit të sezonit të ri turistik. Nevoja për të ndërhyrë nëpërmjet këtij akti normativ, ka lindur pas fluksit të madh të turistëve gjatë vitit 2023. Sipas INSTAT-it, hyrjet e shtetasve të huaj për 8 muajt e parë të vitit 2023 arritën në gati 7.2 milionë persona (7,190,410), me një rritje prej 26.9% në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ndërkohë kjo përqindje është më e madhe, e krahasuar me vitet e mëparshme, pasi viti 2022 ka qenë deri tani viti më i mirë i turizmit që pas pandemisë.

Sipas INSTAT-it vetëm në muajin gusht, që është kulmi i sezonit turistik, në vend kanë hyrë rreth 2 milionë shtetas të huaj ose 18.3% më shumë se sa gushti i një viti më parë. Në këto kushte, duke pasur në vëmendje se kemi rreth 9 000

subjekte, të cilat kryejnë aktivitet ekonomik në zonat bregdetare ose në bregun e liqeneve e të lumenjve, ujërat e ndotura të shkarkuara në ujëra larëse arritën në nivele të larta, duke përkeqësuar cilësinë e ujërave larëse, kjo e matur nga Agjencia Evropiane e Mjedisit, rrjedhimisht dhe situata në mjedis dhe shëndetin e popullatës u përkeqësua ndjeshëm. Me qëllim mbrojtjen e mjedisit, interesit publik dhe zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit dhe vendit në tërësi, nevoja për marrjen e masave për uljen e ndotjes në ujëra larëse në nivele, si të vendeve të Bashkimit Evropian është më se emergjente, përpara se të nisë sezoni i ri turistik.

Duke qenë se afatet janë të ngushta dhe subjekteve do t'iu duhet kohë për realizimin e punimeve është vlerësuar miratimi i këtij akti normativ. Në rast se ky projektakt do të ndiqte procedurën për miratimin e një projektligji, duke pasur në konsideratë që Kuvendi mbyll punimet rreth javës së tretë të muajit dhjetor dhe i nis rreth javës së tretë të muajit janar, standardet e nevojshme nuk do të mund të ishin gati përpara fillimit të sezonit turistik, për shkak se çdo operator do të ketë 90 ditë afat për të plotësuar standardet. Në një përlogaritje të thjeshtë, në rast se ky akt do të miratohej si ligj në muajin shkurt, standardet e kërkuara do të plotësoheshin në fund të muajit maj ose fillim të muajit qershor, ku sezoni turistik ka nisur. Për këto arsye, është vlerësuar emergjenca për miratimin e këtij projektakti si akt normativ.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Akti normativ nuk përafrohet ndonjë akt komunitar dhe nuk lidhet me zbatimin e *acquis* të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Akti normativ përbëhet nga 12 nene, të cilat normojnë, si më poshtë vijon:

Në nenin 1 jepet qëllimi i aktit normativ, i cili ka të bëjë me trajtimin e ujërave të ndotura nëpërmjet vendosjes së impiantit apo sistemit të grumbullimit, trajtimit dhe largimit të ujërave të ndotura nga ana e subjekteve, të cilat kryejnë veprimtari ekonomike në zonat bregdetare dhe bregun e liqeneve e të lumenjve, të cilat nuk i trajtojnë ujërat e ndotura të krijuara nga veprimtaria e tyre ekonomike dhe i shkarkojnë ato pranë ose në ujëra larëse.

Në nenin 2 jepen përkufizimet, të cilat shërbejnë për të sqaruar më tej zbatimin e këtij akti normativ për subjektet që do t'iu adresohet dhe zonat të cilat do të jenë objekt monitorimi dhe kontrolli.

Në nenin 3 përcaktohet fusha e zbatimit e këtij akti normativ, ku është theksuar se dispozitat e këtij akti zbatohen për zhvilluesit e fshatrave turistike, sipas lejes së ndërtimit dhe për subjektet që zhvillojnë veprimtari ekonomike, sipas pikave 1 deri 12, të nenit 2, të këtij akti normativ, në zonat bregdetare ose në bregun e liqeneve e të lumenjve dhe që shkarkojnë ujëra të ndotura të patrajtuar, sipas standardeve të parashikuara, pranë ose në ujërat larëse.

Në nenin 4 janë përcaktuar subjektet që do të monitorohen dhe detyrat që ato kanë me qëllim trajtimin e ujërave të ndotura.

Në nenin 5 parashikohet ngritja e Task-Forcës për zbatimin e këtij akti normativ, si dhe janë parashikuar rregullat për krijimin dhe financimin e saj.

Në nenin 6 jepen detyrat kryesore që do të ketë Task-Forca në ushtrimin e funksionit të vetë.

Neni 7 përcakton që standardet për trajtimin e ujërave të ndotura, që duhet të zbatohen nga subjektet që zhvillojnë veprimtari ekonomike në zonat bregdetare ose në bregun e liqeneve e të lumenjve janë kushtet, rregullat dhe kërkesat e përcaktuara në rregulloren teknike për standardet për trajtimin e ujërave të ndotura. Ministri përgjegjës për infrastrukturën dhe ministri përgjegjës për mjedisin, me udhëzim të përbashkët, miratojnë rregulloren teknike për standardet për trajtimin e ujërave të ndotura, sipas këtij akti normativ, në përputhje me parashikimet e shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr.9115, datë 24.7.2003, “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”, të ndryshuar.

Në nenin 8 janë parashikuar masat administrative që do të ndërmerren nga Task-Forca në rastet e konstatimit të moszbatimit të standardeve për trajtimin e ujërave të ndotura nga subjektet. Mënyra e vendosjes së masave administrative, është bërë duke pasur në vëmendje, nivelin e ndotjes që mund të sjellin strukturat përkatëse nga ato më të mëdha te më të voglat. Kështu, hotelet dhe komplekset turistike, kanë një masë më të madhe administrative sesa bujtinat apo hostelet etj, të cilat janë struktura akomoduese që gjenerojnë ndotje në një nivel më të ulët. Gjithashtu, edhe brenda të të njëjtës kategori është bërë një shkallëzim i vendosjes së masës administrative, me qëllim që struktura e posaçme të ketë në vëmendje masën e ndotjes që ka kryer subjekti. Shembull: një subjekt i kategorisë së dytë, që ka ngarkesën e ndotjes 100 PE, detyrimisht do të ketë një masë administrative më të ulët se një tjetër subjekt i kategorisë së dytë që ngarkesën e ndotjes e ka 170 apo 180 PE. Në rast se edhe pas marrjes së masave administrative, subjektet nuk bëjnë plotësimet dhe rregullimet përkatëse, struktura përgjegjëse vijonë me marrjen e një mase të dytë administrative dhe me propozimin për pezullimin dhe bllokimin e aktivitetit deri në plotësimin e kushteve dhe standardeve. Është vlerësuar që të kemi marrjen e një mase të dytë administrative për të shmangur

marrjen e masës ekstreme të mbylljes apo pezullimit të aktivitetit nga subjekteve që kryejnë aktivitet ekonomik. Në çdo moment, heqja e licencës, me qëllim pezullimin e aktivitet është lënë si masa më e fundit dhe kjo do vendoset pas përfundimit të sezonit turistik.

Në nenin 9 janë parashikuar procedurat dhe veprimet pas marrjes së masës administrative.

Në nenin 10 parashikohet ankimi i drejtpërdrejtë në gjykatë nga ana e subjekteve për masën administrative të vendosur.

Në nenin 11 janë parashikuar dispozita të fundit, të cilat ngarkojnë ministrat përgjegjës që, brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e aktit normativ, miraton rregullat teknike, sipas pikës 2, të nenit 7.

I është lënë një afat 90-ditor, subjekteve për të plotësuar standardet për trajtimin e ujërave të ndotura. Si dhe janë orientuar subjektet që duhet të ndërtojnë impiantin e trajtimit sipas këtij akti normativ për pajisjen me deklaratë paraprake punimesh.

Për zbatimin e këtij akti normativ ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Brendshme, Policia e Shtetit dhe Agjencia Kombëtare e Ujësjiellës-Kanalizimeve.

Në nenin 12 është parashikuar që ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Brendshme, Policia e Shtetit, Agjencia Kombëtare e Ujësjiellës Kanalizimeve, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe institucionet përgjegjëse për dhënien e lejeve përkatëse për kryerjen e plotësimeve të standardeve për trajtimin e ujërave të ndotura.

VIII. INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky akt normativ është hartuar në bashkëpropozim të strukturave të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Akti normativ është hartuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

IX. RAPORTI I VLERESIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky akt normativ sjell efekte financiare me ngritjen e Task-Forcës. Me qëllim funksionimin e kësaj strukture, përlllogaritet një buxhet i barasvlefshëm me 323 860 000 lekë, i cili do të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave për vitin 2024, i ndarë, në:

1. Shpenzime kapitale (kompjutera, mjete, pajisje monitorimi dhe testimi, sisteme + pajisje *tablet*, pajisje zyre etj.)
2. Shpenzime operative (paga dhe sigurime, shpenzime udhëtimi, dieta, materiale printimi, procesverbale, fushatat e informimit, qira zyre, energji, trajnime, kancelari etj).

Struktura e posaçme për monitorimin mbrojtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës së ujërave të ndotura që shkarkohen në ujërat larëse është një politikë e re, e cila nuk është e parashikuar në Programin Buxhetor Afatmesëm 2024-2026, por krijimi i kësaj strukture del i nevojshëm dhe emergjent në kushtet e zhvillimit të vullshëm të turizmit gjatë vitit 2023 dhe pritshmërive për zhvillimin dhe turizmin gjatë vitit 2024.

Ky relacion shpjegues i buxhetit për strukturën e posaçme përmban një plan të detajuar të shpenzimeve të parashikuara për të ndihmuar në krijimin dhe funksionimin e kësaj strukture.

➤ PËR SHPENZIMET OPERATIVE

Kjo strukturë e posaçme është parashikuar të këtë organikën, si në vijim:

Pozicioni	Kategoria e pagës	Numri
Drejtori i Task-Forcës	I-4	1
Përgjegjës i sektorit të monitorimit në terren	III-1	1
Inspektorë në terren	IV-1	38
Përgjegjës i sektorit të analizës	III-2	1
Specialiste sektori i analizës	IV-1	2
Specialist burime njerëzore	IV-2	1
Specialist ekonomist	IV-2	2

Të gjithë shpenzimet operative të strukturës së posaçme janë llogaritur për një periudhë kohore prej 12 muajsh.

Duke marrë në konsideratë që aktiviteti kryesor i kësaj strukture do të zhvillohet në terren, më poshtë paraqiten zërat e shpenzimeve operative, të parashikuara për këtë strukturë.

000 lekë	
Përshkrimi i shpenzimeve	Total
Shpenzime operative	194,360
Shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore, shëndetësore	129,557
Shpenzime për blerje karburanti	6,660
Shpenzime për mirëmbajtje automjetesh	3,521
Shpenzime për udhëtime dieta, hoteleri	24,000
Shpenzime për blerje materiale, printime, procesverbale etj	3,000
Shpenzime për marrje zyra me qira	5,000
Shpenzime fushatë ndërgjegjësimi dhe informimi nëpërmjet medias	15,000
Shpenzime për energji elektrike, ujë, telefon etj	622
Shpenzime për blerje kancelari, tonera etj	2,400
Shpenzime të tjera	4,600

Përshkrimi i shpenzimeve operative sipas zërave paraqitet:

- Shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore: Struktura e pagës dhe planifikimi i shpenzimeve për këtë zë janë në përputhje me përcaktimet e vendimit nr.325, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, ku elementet përbërëse të pagës do të jenë paga bazë e pozicionit, shtesa sipas diplomës/nivelit të kualifikimit, shtesa për vjetërsi në punë, shtesa për kushte pune dhe shtesa për orë jashtë kohës normale të punës.
- Shpenzime për karburant do të përfshihen të gjitha shpenzimet që do të kryhen për blerje nafte apo benzinë, për një periudhë 12-mujore.
- Shpenzime për mirëmbajtje automjetesh janë parashikuar shpenzime për shërbimet e zakonshme profilaktike, si dhe riparimin për shërbime për pjesë xhenerike.
- Shpenzime udhëtime dieta, hoteleri: Në këtë zë përfshihen të gjitha shpenzimet që do të kryhen për udhëtime, dieta dhe fjetje në hotele, për rastet kur punonjësit e strukturës së posaçme do të jenë në terren.

- Shpenzime për materiale printime procesverbale do të ketë një vlerë të konsiderueshme sepse çdo aktkonstatimi duhet të dokumentohet nëpërmjet mbajtjes së provës-verbaleve në disa kopje nga 3 deri në 5 copë.
- Shpenzime për marrje ambjente me qira për zyra: Për llogaritjen e këtij zëri është marrë parasysh kërkesa në m² për një punonjës, çmimi i tregut për njësi dhe numri total i punonjësve (48 punonjës) që do të ketë struktura.
- Shpenzimet për fushatën për informim nëpërmjet medias parashikon shpenzimet që do të shërbejnë si një mjet për të informuar, sensibilizuar dhe udhëzuar të gjitha subjektet me veprimtari në ujërat larës, për zbatimin e aktit normativ. Fushata e ndërgjegjësimit dhe informimit parashikon ndër të tjera krijimin dhe zhvillimin e një plani komunikimi, prodhim dhe transmetim spoti në mediat televizive, media radiofonike etj.
- Shpenzime për ujë dhe energji elektrike janë faturimet mujore për furnizimin me ujë dhe energji elektrike, për ambjentet e zyrave, të cilat zënë një përqindje të vogël në totalin e shpenzimeve.
- Shpenzime për kancelari dhe tonera i takojnë shpenzimeve të përditshme për kancelari për punonjësit si dhe të tjera shpenzime të domosdoshme për mbarëvajtjen e aktivitetit.
- Shpenzime të tjera janë menduar shpenzime, si për siguracion automjetesh, shërbime dhe riparime të pajisjeve të zyrave, shpenzime për kolaudim automjetesh, materiale pastrimi, etj. Vlera totale prej 323 860 000 lekësh, e nevojshme për shpenzime kapitale dhe operative kërkohet të mbulohet nga buxheti i shtetit.

➤ **SHPENZIMET KAPITALE**

Për krijimin dhe funksionimin efikas të kësaj strukture të posaçme kërkohet një investim fillestar i cili përfshin shpenzimet e domosdoshme për të krijuar kushtet e duhura të punës. Sa më sipër, këto investime përfshijnë blerjen e pajisjeve teknike për inspektime në terren dhe pajisje monitorimi, mjeteve lëvizëse dhe sistemeve informatike.

Gjithashtu, janë parashikuar në buxhet mobilimi i zyrave dhe pajisje e tyre me mjete të nevojshme pune.

Në vijim, paraqitet në mënyrë të detajuar buxheti i kërkuar për shpenzime kapitale, sipas zërave:

000 lekë

Përshkrimi i shpenzimit	Total
Shpenzime kapitale	129 500
Shpenzime për blerje kompjutera, printera, fotokopje etj	9 000
Shpenzime për mjete transporti	50 000
Shpenzime për mjete pune, monitorimi dhe testimi	30 000
Shpenzime për blerje sistem informatik dhe pajisje tereni/ <i>tablet</i>	30 500
Shpenzime për blerje mobilje dhe pajisje zyre	10 000

➤ **Të ardhurat**

Struktura e posaçme ka si qëllim marrjen e masave për subjektet, të cilat kryejnë veprimtari ekonomike në zonat bregdetare ose në bregun e liqeneve e të lumenjve dhe nuk trajtojnë ujërat e ndotura të krijuara nga aktiviteti i tyre. Nga veprimtaria e strukturës së posaçme parashikohet të arkëtohen të ardhura nga gjambat për ato subjekte që nuk zbatojnë ligjin. Të ardhurat nga vendosja e masave administrative arkëtohen në buxhetin e shtetit.

KËSHILLI I MINISTRAVE